

Dëfrim SALIU, Shejnaze AJDINI-MURTEZI, Besa SALIU
MEMOIRS OF HADRIEN BY MARGUERITE YOURCENAR

Abstrakti: Për të analizuar një vepër letrare duhet një guxim i vërtetë intelektual, por edhe më e rëndësishme është që të kesh një shkallë të lartë dashurie të zjarrtë dhe magjepsëse për veprën e cila është në fakt lëndë studimi, por edhe për autorin e saj. Marguerite Yourcenar-i, duke shkruar, arrin t'i paraqesë në mënyrë të qartë personazhet e saj e ia del me sukses që me një zë të flasë me ata. Pra, në këtë mënyrë ajo flet me zërin e perandorit romak, kthehet në lëkurën e tij, shpreh idetë dhe jetën e tij intime. Këtu është me rëndësi të theksohet se vdekja si një fatkeqësi e pashmangshme e njeriut rrëfëhet në shumicën e veprave të kësaj autore. Vdekja në këtë roman manifestohet në mënyra të ndryshme, si: sëmundje, vetëorasje, ritual sakrificash, vdekje natyrore dhe vdekje e dhunshme. Afërsia e vdekjes, padyshim është një nga elementet më të rëndësishëm që i determinojnë memoaret e saj. Ne këtu do të përpiqemi që së pari të dallojmë vdekjet e diferencuara në kuadër të perandorit, për të përshkruar mandej ngjarjet dhe impaktin e vdekjes së Antinoüs-it dhe në fund për të përfunduar me vdekjen personale të perandorit.

Fjalët kyçe: Memoaret, Hadrian, Yourcenar, vdekja, perandori.

1. Hyrje

Marguerite Yourcenar, në një moment të dhënë, e kishte lënë anash të shkruarit e romanit *Mémoires d'Hadrien*, për t'iu rikthyer më pastaj, duke bërë një nga veprat më të jashtëzakonshme të shekullit XX. Ajo vlerësoi se : « Ka libra të cilët nuk guxojnë të lejohen para se të kalojnë dyzet vjet. Para kësaj kohe, rrezikohet që të mos pranohet qëndrimi i kufijve të mëdhenj natyralë që ndajnë individin nga individi, shekullin nga shekulli, pafundësisht larminë e qenieve,... Më kanë munguar këto vite për të mësuar të llogaris me përpikëri distancat mes perandorit dhe meje » (Yourcenar, 1974, 31). Në universin e vet kompleks e mbivlerëson preokupimin për njeriun dhe fatin e tij. E preokupuar me vdekjen, por gjithashtu pa e lënë atë të qetë gjatë jetës, ajo e transmeton në personazhet e saj shtegtimin e jetës.

2. Marguerite Yourcenar

Marguerite Yourcenar-i u lind më 8 qershor 1903 në Bruksel nga nëna belge dhe i ati francez nga një familje e vjetër flandreze. Është autore e shumë romaneve, ndërsa si kryevepra janë *Mémoires d'Hadrien* (Memoaret e Adrianit), botuar në vitin 1951 dhe *L'oeuvre au noir* (Vepra në të zezë) në vitin 1968. Ajo ka lënë gjithashtu edhe tri vepra të tjera, siç janë *Souvenirs pieux* (Kujtimet hyjnore), botuar në vitin 1974, *Archives du Nord* (Arkivet e Veriut), botuar në vitin 1977 dhe *Quoi? L'Eternité* (Çfarë? Përjetësia), botuar në vitin 1988 (Savigneau, 1990, 15).

Ka fituar çmimin *Femina* më 1968 dhe ka hyrë në histori si gruaja e parë e zgjedhur në Akademinë Franceze më 6 mars të vitit 1980, pas një mbështetjeje aktive të Jean d'Ormesson-it, i cili do ta përgatisë fjalimin e pranimit të saj. Gjatë fjalimit ajo prononcohet në prezencë të kryetarit Valéry Giscard d'Estaing dhe thotë: « *Të hysh në Akademi, e rrethuar, e shoqëruar nga një grup i paparë i burrave të cilët do të kenë thënë, e fitofsh sa më parë këtë nderim të lartë, në çastin kur kam tentuar të tërhiqem për t'i lënë hijet tyre* » (Savigneau, 1990, 19).

Marguerite Yourcenar-i vdiq më 17 dhjetor 1987 në Mount Desert Island në shtetin Mainde të SHBA-ve, ku kishte migruar qysh më 1939, për t'u lidhur sërish me Grace Frick-un, mikeshë e saj, me të cilën ka jetuar deri në vdekjen e saj, në vitin 1979. Shija e saj e zbulimit, kurioziteti i saj për botën, dëshira e saj e inspirimit, krijimtaria dhe lakmia për t'i gjetur ndoshta ndonjë ditë përsëri vendet, origjinat ose burimet, e shtynë Yourcenar-in, qysh nga rinia e saj në një varg udhëtimeve nëpër katër kontinentet. Pas vendqëndrimeve të shumëfishta si në Itali, Greqi e Egjipt, ajo bëhet jo vetëm admiruese, por gjithashtu një nga njohësit më të mëdhenj të qytetërimeve greke dhe romake.

3. Fillimi i një historie

Projektin fillestar për romanin e saj *Mémoires d'Hadrien* (Memoaret e Adrianit) e nis në vitin 1924. Para vitit 1924, Yourcenar-i dhe babai i saj Michel-i kishin bërë disa udhëtime në Zvicër e në Itali, ku kishin vizituar Villa Adriana në Tivoli, pastaj kishin vazhduar për në Greqi dhe në disa vende të Azisë së Vogël. *Këtë roman do ta shkruaj kudo, si në tren gjatë udhëtimeve dhe atë kohë pas kohë, jo në mënyrë të vazhdueshme*, kishte deklaruar ajo. Për fat të keq, duke mos mundur që ta publikojë në mundësinë e parë, ajo i ndërpret punët rreth tij, për të vazhduar mëtej me hulumtime.

Romani është i shkruar me shumë përsëritje, për të qenë i tërhequr më 1939: « *në mes viteve 1939 dhe 1948 [...] kam tërhequr tërë idenë për të shkruar, bëja diçka tjetër, kurseja jetën time* » (Yourcenar, 1974, 123). Më 1949, Yourcenar-i pranoi një valixhe të cilën e kishte lënë në Zvicër gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore. Valixhja përmbante dokumente të familjes dhe letra të vjetra të veçanta. Kështu, ajo kalon netët përpara zjarrit duke i shkatërruar dokumentet për të cilat mendonte se janë të parëndësishme, letra nga individët që i kishte njohur në momente të caktuara të jetës së saj, ose shumë të tjerë që i kishte harruar, deri sa nuk has në një dokument me një regjistrim: « *I dashuri Marc...* ». Marku duke qenë në fillim një emër me çka ajo u përpoq të sjell ndërmend: « *[...] Nga cili mik, nga cili i dashur, nga cili fis të ndikohej [...]* » (Yourcenar, 1974, 167).

Duke arritur deri te fakti se Marc-u ishte vënë aty për Marc Aurèle-in, ajo para syve të saj kishte një fragment të një dorëshkrimi të humbur të *Mémoires d'Hadrien*. Ky ishte një moment vendimtar për vazhdimin e shkrimit të librit, i cili u botua më 1951 nga shtëpia botuese Plon. Vazhdimisht i ribotuar nga viti 1951 deri në vitin 1958, ky roman do të arrijë një tirazh prej

96.000 kopje dhe drejtpërdrejt do të ndeshet me një sukses të jashtëzakonshëm ndërkombëtar duke i siguruar famë më të madhe.

4. *Mémoires d'Hadrien* - roman historik

Mémoires d'Hadrien (Memoaret e Adrianit), është një roman historik në të cilin përshkruhet jeta dhe sundimi i perandorit romak Hadrien. I rrëfyer në vetën e parë, nga pikëpamja e Hadrien-it, në formë të një letre të gjatë, e cila i adresohet perandorit të ardhshëm Marc Aurèle-it. Romani është i përbërë prej gjashtë kapitujve me tituj në latinisht që dalin me tekste historike që datojnë që nga sundimi i Hadrien-it: *Animula vagula blandula* (Shpirt i vogël, shpirt luftarak), *Varius multiplex multiformis* (I shumëfaqshëm dhe shumëformësh), *Tellus stabilita* (Paqja u vendos), *Saeculum aureum* (Vitet e arta), *Disciplina augusta* (Disiplinë e fortë) dhe *Patientia* (Durimi).

Në kapitullin e parë *Animula vagula blandula* (Shpirt i vogël, shpirt luftarak) ai i drejtohet sëmundjes së tij dhe ideve mbi njeriun dhe vdekjen e tij. Në këtë kapitull ai përshkruan jetën e tij që nga fëmijëria e deri në hyrjen e tij në fron si perandor.

Në kapitullin e dytë *Varius multiplex multiformis* (I shumëfaqshëm dhe shumëformësh) Hadrien-i rrëfen për jetën e tij në Italikë (Spanjën e sotme), për familjen e tij, ardhjen e tij në Romë, studimet dhe njohjen e parë me letërsinë greke, sa që në Romë njihej si *studenti grek*. Kapitulli i tretë *Tellus stabilita* (Paqja u vendos) shënon një kthim të ekuilibrit të vendit me mbështetje të udhëtimeve të realizuara nëpër provincat e perandorisë për të rikthyer rendin dhe për të stabilizuar kufijtë.

Në kapitullin e katërt *Saeculum aureum* (Vitet e arta) tregon kulminacionin e sukseseve të Hadrien-it, sa në jetën e tij politike aq edhe në jetën intime. « [...] Ky është moment i vetëm ku Hadrien-i plotësisht është zmbarsur nga vullneti i qartë personal, ku ai e ka ndërjet [...] se jeta po e linte pas » (Savigneau, 1990, 25). Fati brutalisht është shkatërruar nga vetëvrasja dramatike e Antinoüs-it, për shkak të së cilës Hadrien-i fundoset në një krizë të thellë shpirtërore.

Kapitulli i pestë *Disciplina augusta* (Disiplinë e fortë) në të cilin Hadrien-i rrëfen për kënaqësitë dhe vuajtjet e shteruara, për atë që nuk i mbetet gjë përveç disiplinës të cilën e praktikon në perandorinë e tij. Punët e vetme që e interesojnë janë trashëgimia e ardhshme dhe vdekja së cilës stoikisht i bën ballë.

Pjesa e gjashtë *Patientia* (Durimi) rrethohet nga epilogu, i dominuar nga pritja e vdekjes dhe përpjekjet për ta mbajtur stabil vendin e mbyllur. Hadrien-i kishte gjashtëdhjetë vjet në kohën kur i shkruan memoaret e tij, por kjo nuk është moshë e cila importohet, por siguri e fundit të jetës së tij.« Unë filloj ta parandjej profilin e vdekjes sime » (Yourcenar, 1974, 38).

Vdekja është e sigurt, por koha jo. Vdekja e sigurt, koha e pasigurt. Koha është e çmueshme. Alain Trouvé në *Leçon littéraire sur Mémoires d'Hadrien de Marguerite Yourcenar* (Ligjëratën letrare

mbi Mémoires d'Hadrien) shkruan: « Për ta përjetuar tërësisht këtë përvojë të kohës, shkrimi është mjet i pazëvendësueshëm: **Aktivitetet e «argëtimit»**, lejojnë që më mirë të harxhohet pjesa e energjisë së pamjaftueshme që t'i destinohet punëve të shtetit [...]. Në **shërbim të meditimit**, ajo i përgatit vdekjes [...], **Ushtrimet e kujtimit** (kujtesës) lejojnë të rikthehet e kaluara, të definohet duke rrefyer, dhe më pastaj të njihet më mirë para se me vdekur... » (Trouve, 1996, 41).

Gjatë ditëve të fundit të qeverisjes së Domitien-it, ai kthehet në Romë dhe gjatë kohë punon si gjykatës. Jetoi një jetë të bujshme deri sa u rikthye në armatë në Gadishullin Pirinej. Atëherë, kur ai shërbente në Spanjë, Domitien-i u pushkatua dhe qe Nerva ai që e zëvendësoi. Nerva duke qenë i moshuar e adoptoi Trajan-in, kushëririn e Hadrien-it, i cili më vonë do ta birësojë Hadrien-in. Trajan-i është i pasigurt ndaj vlerave të Hadrien-it dhe kompetencave të tij.

Hadrien-i do ta zëvendësojë Trajan-in në rrethana të errëta dhe pak të dyshimta për armiqtë e tij. Trajan-i para se të vdiste, ia dikton Plotine-ës emrin e zëvendësit: « *Unë kam mbajtur mes duarve të mia që moti këtë dokument aq rreptësisht të kontestuar prej kundërshtarëve të mi. Nuk mund të prononcohem për ose kundër autenticitetit të këtij diktimi të fundit të bërë nga një i sëmurë* » (Yourcenar, 1974, 99).

Hadrien-i është një njeri i veçantë dhe tepër inteligjent. Nga momenti kur bëhet perandor, ai kërkon që ta etablojë paqen në perandori, të gjejë një harmoni: « *E doja fuqinë. E doja për të shtruar planet e mia, të provoj mjetet me të cilat do ta rikthej paqen. E doja mbi të gjitha, të jem vetja ime para se të vdes* » (Yourcenar, 1974, 106). Një qeveri të humanitetit, të lirisë dhe lumturisë ashtu si fjalët që figuronin në monedha gjatë kësaj periudhe *Humanitas, Felicitas, Libertas*.

Ai kryen punë të shumta nga arkitektura, praktikon të gjitha sportet, nxjerr ligje të arsyeshme, i adhuron artet dhe shkencat. Hadrien-i shumicën më të madhe të sundimit e kaloi jashtë Romës. Gjatë kalimit të tij në Bithynie, ai takon një grek të mirë me emrin Antinoüs të cilin e dashuron. Djali i ri bëhet mik i tij, ai nuk ndahet më nga Hadrien-i deri sa një ditë ai vendos të sakrifkohet për perandorin. Antinoüs-i përshkruhet si personazh më i përfolur në roman. Pas luftës së Judée e cila për Hadrien-in qe një disfatë e veçantë ai vendos që të kthehet në Romë.

5. Vdekja si temë e memoareve

Marguerite Yourcenar-i duke u bazuar në fletoret e shënimeve të Hadrien-it shprehet: « *Fjalja e vetme e cila ende gjendet në redaksionin e 1934. Unë filloj ta parandiej profilin e vdekjes sime. Si një piktor i ngritur në horizont i cili pa ia ndarë i lëviz shkallët e tij në të djathtë, pastaj në të majtë, më në fund e kisha vërejtur pikëpamjen e librit* » (Yourcenar, 1974, 162). Në të vërtetë ky rrëfim, si shumë vepra narrative të Marguerite Yourcenar-it ka filluar me vdekjen si element përbërës, duke marrë si pikënisje frikën nga vdekja e ardhshme: « *I dashuri im Marc, sot në mëngjes isha te mjeku im Hermogène, [...] Po të kursej hollësitë që do të ishin për ty po aq të pakëndshme sa janë për mua, e*

përshkrimin e trupit të një njeriu me moshë të thyer që po vdes prej hidropizisë së zemrës » (Yourcenar, 1974, 178).

Vdekja në tregim transformohet në impuls që fillon nga rrëfimi i gjatë kur Hadrien-i shfaq ndjenjën se ka ardhur koha të përmbledh ngjarjet e kaluara gjatë jetës dhe të përgatitet ta shtjellojë fenomenin e vdekjes. Rrëfimi përgjatë gjithë tregimit të gjatë pashmangshëm e afron personazhin e objektivit të përmbajtur që nga faqja e parë me arsyen e fenomenit të sëmundjes. Përveç se është element « fillestar », vdekja bëhet element përbërës i cili tregon etapat e ndara të narracionit, vdekja e të tjerëve, vdekja Antinoüs-it dhe vdekja personale e tij.

Efikasiteti në fuqinë e perandorit është bazuar mbi vdekjen e Trajan-it. Vdekja e Antinoüs-it shënon ndryshim fundamental në diskursin intim të perandorit. Kështu, itinerari i jetës së Hadrien-it më pastaj është etabluar si një udhëtim i vazhdueshëm ku vdekja nuk është vetëm shenjë e shumë etapave suksesive të tregimit, por gjithashtu paraqet përcaktimin final. Gjatë tërë jetës së tij Hadrien-i është konfrontuar me vdekjen: vdekja e të afërmëve të Hadrien-it, gruaja e tij, Trajan-i, Plotine-a, Nerva, Lucius-i, dhe ajo që e ka tronditur më së shumti, vdekja e Antinoüs-it.

Disa nga mjedisi i tyre e kanë dhënë jetën për të, ndërsa disa të tjerë e kanë ndihmuar ngritjen e tij - katër konsujt Celsus, Palma, Nigrinus dhe Quiétus të rrezikshëm për suitën e mirë të Hadrien-it. Fjalët e para që Hadrien-i i evokon në letrën e tij të gjatë janë ato të familjes. Karakteristikë e tyre e përbashkët është të shfaqurit e tyre duke e zgjatur rininë e personazhit, shumica prej tyre janë treguar me shumë emocione dhe me vetë dobësitë. Pak më andej, Hadrien-i evokon vdekjen e Plotine-ës, bashkëshortes së Trajan-it, e cila është megjithatë e para që duhet të diskreditohet me një antipati të vërtetë.

Plotine është gjithashtu personazhi i vetëm me të cilën perandori kishte një marrëdhënie të sigurt afërsie dhe mallëngjyese. E buzëqeshur, pak e lodhur, që nomenklatura zyrtare i jepte atij për nënën, e cila ishte, akoma më tepër, mikështa e tij e vetme. Plotine luajti rolin determinant të hyrjes së Hadrien-it në fron. Tentativa e Trajan-it për ta shkatërruar para se të emërohet zëvendës i tij, Hadrien ia vesh paaftësisë së paraardhësit të tij që ta merr mbi vete fundin: « *Ai refuzonte të përballlet me fundin e tij, kështu shihet, te familjet, te pleqtë kokëfortë për të vdekur pa testament » (Yourcenar, 1974, 181).*

Një tjetër vdekje mes të afërmeve të Hadrien-it, është ajo e Lucius-it të ri (emëruar Ælius Cæsar), djalit të adoptuar të Hadrien-it dhe i zgjedhuri parë për zëvendësim të perandorit, duke reprezentuar kështu itinerarin e një jete të ndërprerë në rininë e plotë: « *Shumë shpesh më ka ikur nga syri, pastaj sërishmi e kam gjetur Lucius-in në rrjedhën e viteve që e ndoqën, kur rrezikoj t'ia ruaj fotografinë e kujtimeve të paluara njëra mbi tjetrën që nuk korrespondon me ngarkesën e asnjërës fazë të jetës së shpejtë » (Yourcenar, 1974, 192).*

Hadrien-i gëzohet mbi Lucius-in deri në fund, dëshmitar i luftës që ky i fundit e bën kundër dhimbjeve të sëmundjes së tij. Një luftë që Hadrien-i më vonë do të jetë i obliguar t'ia bëjë vetvetes, prej ku vdekja do të bëhet lehtësim i tillë siç qe për Lucius: « *Vdekja nuk qe veçse një pakujdesi për këtë qenie të dobët* » (Yourcenar, 1974, 201).

Deri më tani kemi përmendur personazhet që patën lidhje të afërt me Hadrien-in, shumica e të cilëve shuhen prej vdekjes natyrore. Ndërkaq, në roman Hadrien-i përmend figura të vdekjes vullnetare, në të cilën vetëvrasja bëhet si shprehje e pavarësisë dhe të rebelimit të gjinisë njerëzore, pjesë e fatit. Nga personazhet që janë përcaktuar t'i përfundojnë jetët e tyre nga vullneti personal, siç është Antinoüs-i, pastak Euphratësi cili seriozisht i sëmurë, kërkon leje prej Hadrien-it që t'ijep fund jetës.

Hadrien ia lejon autorizimin dhe i përgjigjet përmes Antinoüs-it: « *Kurrë nuk duket më thjeshtë, njeriu ka të drejtë të vendos të shkojë prej momentit kur e sheh se jeta e tij pushon të jetë e dobishme* » (Yourcenar, 1974, 218). Do të përmendim gjithashtu Iollas, i cili duke e gjetur në situatë delikate dhe duke mos mundur ta shkelë detyrën e tij prej mjeku e jo më të refuzojë kërkesën e Hadrien-it që ta ndihmojë komplotin e vetëvrasjes personale, zgjedh për t'i dhënë fund jetës së tij me helmin që ia reklamon Hadrien-i. Të gjitha këto figura të përmendura, disa më shumë se të tjerat, kanë formuar universin e njerëzve me vdekjen e të cilëve, Hadrien-i e ka shtuar jetën e vet personale (Trouve, 1996, 67).

6. Përfundimi

Ne jetojmë në një univers ku vdekja është përparësi e panjohur ose mbrojtje e larguar e mendimeve tona. Me ankth dhe frikë ky mendim i krijuar në qenien njerëzore nuk mund të mos përfillet. Vdekja mund ta theksojë fundin absolut të diçkaje të dukshme, një qenie njerëzore, një kafshe, një peme, një miqësie. Vdekja është ndoshta si fund i jetës nga kundërshtia e lindjes, ose si mungesë e jetës. Agonia e vetëdijshme na lejon ta ndihmojmë procesin e të jetuarit deri në fund, në kalimin e fazave dhe etapave. Megjithatë t'i bësh ballë vdekjes qoftë edhe një të afërmi ose ajo individuale është vështirësi e pakontestueshme.

Në veprën e Marguerite Yourcenar-it ka një proces të familjarizmit dhe të njohjes me procesin e vdekjes përmes një rrëfimi të gjatë, që lejon se fundmi qoftë edhe qetësinë dhe kthjelltësinë, të cilat e drejtojnë kah tranzicioni i lehtë. Hadrien-i edhe vdekjen e bën më të pranueshme kah fundi i tregimit.

Të shumta janë veprat e Marguerite Yourcenar-it në të cilat rruga e gjatë kah vdekja e personazheve të saj koicidon me fundin e tregimit. Në falënderimin e përmortshëm, miku i saj Walter Kaiser thoshte: « *Ajo kishte menduar shumë për vdekjen. Në të vërtetë për aq sa unë kam njohuri, asnjë autor tjetër i tërë letërsisë botërore nuk e ka përshkruar kaq gjallërisht aktin e vdekjes* » (Yourcenar, 1974, 49). Josyane Savigneau, gjithashtu e hap biografinë e Marguerite Yourcenar-it

dhe tema e vdekjes që e rëndësishme dhe markante gjatë jetës së saj. Marguerite-a e vogël ka ardhur në këtë botë nën simbolin e vdekjes.

Një kritik ka vërejtur se personazhet e saj më me dëshirë janë të ekspozuar në perspektivën e vdekjes së afërme, sesa mohimi i gjithë domethënies për jetën. Por, tërë jeta do të thotë një çerdhe insekti dhe ndjenjë e rëndësisë së saj, për çdo rast e fuqishme për atë që e ka përjetuar, ose së paku nga kërshëria e vetme e saj. Për herë të fundit i shfrytëzoj fjalët e Yourcenar-it për të përfunduar me këtë vepër: « *Tregtia jonë me më të afërmin s'ka kohë, kënaqësia njëherazi u ndërpre, mësimi u mjegullua, shërbimi u kthye, vepra u krye. Aq, sa isha i zoti për të thënë, e thash, se çfarë mundesha të mësoj e kam mësuar. Të angazhohemi për një kohë të veprave tjera* » (Savigneau, 1990, 157).

Bibliografia

- Blanckeman, B. (2006). *Les diagonales du temps: Marguerite Yourcenar A Cerisy*. Rennes: PUR.
- Jursenar, M. (2005). *Kujtimet e Adrianos*. Prishtinë: Koha Ditore.
- Savigneau, J. (1990). *Marguerite Yourcenar: L'invention d'une vie*. Paris: Gallimard.
- Trouve, A. (1996). *Leçon littéraire sur Mémoires d'Hadrien de Marguerite Yourcenar*. Paris: PUF.
- Yourcenar, M. (1974). *Mémoires d'Hadrien*. Paris: Gallimard.
- Yourcenar, M. (1993). *Novela orientale*. Tiranë: Dituria.